



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 97
Prishtinë, më 11 shkurt 2013

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 11 SHKURT 2013**

Mbledhjen e kryesoi Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, e paraqiti kryetari i këtij komisioni, deputeti Arben Gashi.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi edhe deputetja Albulena Haxhiu, diskutimi i plotë i së cilës është dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara në këtë projektligj.

Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1 dhe 2.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 51,
Kundër ----- 33,
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për kompetencat zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit Funkcional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.

Raportin me rekomandime, në emër të Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, e paraqiti kryetarja e këtij komisioni, deputetja Safete Hadërgjonaj.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Arben Gashi, në emër të Komisionit për Legjislacion dhe të GP të LDK-së, kryetari Jakup Krasniqi, Alma Lama dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari i hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9.

Kuvendi, me propozim të kryetarit, me shumicë absolute të votave të deputetëve e miratoi plotësimin e emërimit të ligjit, ashtu që pas lidhëses “dhe” shtohet fjala “*parandalimin*”.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 94,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr 03/L-196 për parandalimin e pastrimit të parave dhe parandalimin e financimit të terrorizmit.

3. Shqyrtimi i propozim-Strategjisë dhe Planit të Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017

Kryetari i njoftoi deputetët se në mbledhjen plenare, të mbajtur më 24 janar 2013, pas përfundimit të diskutimeve, Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Komisionin për Integritet Evropian që mbi bazën e diskutimeve në atë mbledhje plenare, ta plotësojnë tekstin e propozim-Strategjisë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017 dhe Kuvendit t'ia paraqesin tekstin përfundimtar.

Në vazhdim, kryetari tha se Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për Integritet Evropian e kanë shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017 dhe Kuvendit i kanë rekomanduar që të procedohet me raportet dhe rekomandimet e komisioneve nga mbledhja plenare e datës 24 janar 2012.

Deputeti Arben Gashi, në emër të Komisionit Funkcional për Legjislacion, tha se komisioni e kemi shqyrtuar propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për periudhën 2013-2017 dhe Kuvendit ia ka paraqitur përfundimin që kjo çështje të riprocedohet sipas raportit me rekomandime nga mbledhja plenare e mbajtur më 24 janar 2013, ngase nuk ka praktika të plotësimit të strategjive të institucioneve të pavarura.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Ardian Gjini, Arsim Bajrami, kryetari Jakup Krasniqi, Armend Zemaj dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim propozim-Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 54,
Kundër -----45,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Strategjinë dhe Planin e Veprimit kundër korrupsionit për vitet 2013-2017.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e sotme në orën 15:00 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale